



Pranuar / Dorezuar Priljena / Pridato Received / Delivered	27.09.2023	viti god Year	3
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shënjë Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKIMSHICK	6281/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1074/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1074/2023, të datës 11.08.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër organit të punësimit: Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike „masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.09.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1074/2023, e datës 11.08.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anulohet masa disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuesit përmes shkresës me numër protokolli 278/2023, të datës 19.07.2023, të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Divizionit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, pranë Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore, në Administratën Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e ankuesit dhe regjistri përkatës masën disiplinore “Vërejtje”, e anuluar si në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, [redacted] (ne tekstin e mëtejme ankuesi), me datë 11.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1074/2023, kundër masës disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuesit nga Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Divizionit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj,



në Administratën Tatimore të Kosovës (*tutje referuar ATK*), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, respektivisht aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, me datë 21.08.2023. ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 5621/2023, të datës 11.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me Nr.Prot.278/2023 të datës 19.07.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit; Raportin e verifikimit paraprak VPI me nr.04/23 të datës 06.06.2023 nga Divizioni për Standarde Profesionale; Kërkesën me numër 1730/2023 të datës 24.03.2023, lidhur me korigjimin e numrave personal; Autorizimin për informata tatimore sipas numrit serik 2482823 të datës 24.03.2023; Kopjen e letërnjoftimit për D.Q; Kërkesën për korigjimin e kontributeve nga L.F; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.08.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.08.2023 nga Administrata Tatimore të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.230/2022 të datës 27.12.2022; Vendimin për transferimin e nëpunësit civil (ankuesit) për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me Nr.230/2022 të datës 20.12.2022; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Inspektor i lartë tatimor; Komunikimet elektronike të datës 19.07.2023, 13.07.2023, 10.07.2023, 06.06.2023 ndërmjet zyrtarëve në Administratën Tatimore të Kosovës lidhur me lëndën e ankuesit; Komunikimet elektronike të datës 12.09.2023, 11.09.2023 lidhur me provat shtesë të kërkuara nga ana e Këshillit për ATK-në për lëndën e ankuesit; E-mailat e dërguar nga XH.R dhe D.Q lidhur me rastin e ankuesit; Komunikimet elektronike të datës 30.05.2023 dhe 25.05.2023 ndërmjet me personat gjegjës lidhur me rastin e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit [REDACTED] është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.230/2022 të datës 27.12.2022, ushtron pozitën e punës "Inspektor i lartë tatimor" në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj-Divizioni për Aktivitete Operative.

Me datë 19.07.2023, Zëvendës Udhëheqësja e Divizionit të Divizionit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, në cilësinë e Udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankuesit, duke u bazuar në Rekomandimin e Divizionit për Standarde Profesionale sipas Raportit me numër të rastit Nr.04/23 VPI, të datës 06.06.2023, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje", për shkak të komunikimit dhe sjelljes jo të mirë që ankuesi ka pasur ndaj zyrtarëve të tatimpaguesit Zagragja&Associates.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore e kundërshtuar me ankesë përmban shkelje esenciale të



dispozitive procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të ligjit material, respektivisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Shton se tatimpaguesi Zagragja&Associates, me datë 24.03.2023 ka bërë kërkesës në ATK për korrigjim të trustit pensional, përkatësisht për bartje të kontributeve pensionale nga llogaria e një persona në llogarinë e personit tjetër. Kërkesa në fjalë me është përcjellë nga udhëheqja me datë 28.03.2023, ku duke parë së kërkesa nuk është plotësuar me dokumente të nevojshme, dy apo tri ditë pas pranimit të kërkesës kam kontaktuar përmes telefonit me zyrtaret e biznesit duke kërkuar dokumentet shtesë. Diku me datë 07.05.2023 nga tatimpaguesi me janë sjell vetëm një dokument nga pesë dokumentet e kërkuara për të bërë transferimin. Procedura e korrigjimit është procedurë serioze dhe kërkon aktivitet të inspektorit, dhe një seri veprimesh, sepse duhet të bëhet komunikimi me palët që janë të përfshira në korrigjim, dhe vet personi ku kanë shkuar mjetet gabim duhet të jap deklaratë që mjetet të hiqen nga llogaria e tij dhe në mungesë të kësaj deklarate tërheqja mund të bëhet vetëm me procedurë gjyqësore. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet masën disiplinore "vërejtje" të shqiptuar me datë 19.07.2023.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitive të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: *"... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3.... 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar."*

Nenit 47 paragrafin 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*.

Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil."*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitive ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes, përkatësisht Raportin e Divizionit të Standardeve Profesionale të ATK-së me numër të rastit 04/23 të datës 06.06.2023, mbi bazën e të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore e kundërshtuar më ankesë, e që sipas këtij raporti rrjedhë se komunikimi i ankuesit në pozitën e inspektorit me përfaqësuesit e tatimpaguesit Zagragja&Associates, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 2 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes së ATK-së si dhe ka rekomanduar që mbikëqyrësi i ankuesit të veprojnë sipas nenit 16 të Kodit të Etikës së ATK-së, e që në vlerësimin e Kolegjit Divizioni i Standardeve Profesionale të ATK-së nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen e fakteve, ngase i tërë konstatimi lidhur me



përgjegjësini e ankuesit bazohej në deklaratën e Yll Zagragjes-përfaqësuesit të tatimpaguesit Zagragja&Associates, i cili nuk ka qenë palë direkte komunikuese me ankuesin, dhe se deklarata gjegjësisht ankesa e tij, i referohej vetëm e-mailave të dy punëtorëve me inicialet D.Q dhe XH.R (e-maila nga të cilat nuk vërehet datat e komunikimit), rrjedhimisht, në procedurë para DSP-së nuk ishin dëgjuar punëtorët në fjalë të tatimpaguesit dhe as vet ankuesit nuk i ishte dhënë e drejta e dëgjimit dhe parashtrimit të argumenteve, apo të dëgjohej edhe zyrtari tatimor i cili sipas ankuesit dhe punëtorëve të tatimpaguesit ka qenë prezent në ditën kur është parashtruar kërkesa për korrigjim nga pala-tatimpaguesi.

Nisur nga fakti, se masa disiplinore është shqiptuar për shkelje të lehtë disiplinore, Kolegji duke ju referuar dispozitave të nenit 16 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes së Zyrtarëve të ATK-së, vlerëson së çështja e përgjegjësive disiplinore e ankuesit duhet të trajtohej nga mbikëqyrësja e ankuesit, e cila sipas emalit të datës 13.07.2023, kishte konfirmuar se deri në pranimin e Raporti të DSP-së nuk ka pas njohuri për ankesë apo sjellje jo të mirë të inspektorit, rrjedhimisht, në rastin konkret mbikëqyrësja e ankuesit bazuar në raportin dhe të gjeturat e DSP-së e në mbështetje të nenit 50 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, do të vlerësonte përgjegjësini apo jo përgjegjësini e ankuesit lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara.

Andaj, bazuar në gjendjen e fakteve si më lartë, Kolegji vlerëson se organi i punësimit nuk ka arritur të argumentoj në mënyrë të plotë dhe të drejtë përgjegjësini disiplinore të ankuesit pasi që nuk janë ofruar dëshmi që vërtetojnë plotësimin komulativ të elementeve të përgjegjësive disiplinore siç përcaktohet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, citojmë: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit",* kështu që mbi këtë bazë konstatohet se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit si në ankesën A.nr.1074/23.

Bazuar në gjendjen e fakteve dhe bazën ligjore si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1074/2023

Ardita Perçuku Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së